



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 56, Datë 10.03.2025

MBI

**MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË BORDIT TË ERE-S NR. 11
DATË 03.03.2025**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; dhe nenit 5, pika 4 të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.144, datë 30.09.2019, e ndryshuar me vendimin nr. 199, datë 27.11.2020; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.03.2025 pasi u njoh me përmbajtjen e procesverbalit të Mbledhjes së Bordit datë 03.03.2025, të mbajtur nga Sekretaria e Bordit,

Vendosi:

1. Miratimin e procesverbalit të Mbledhjes së Bordit të ERE-s nr. 11 datë 03.03.2025. (Procesverbali bashkëlidhur).
2. Procesverbali i miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari i Bordit.
3. Ngarkohet për arkivimin e këtij vendimi dhe procesverbalit Sekretaria e Bordit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.